



UNITED NATIONS
ALBANIA



T'I JEPET FUND DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË SHQIPËRI

PARASHTRIM I POZICIONIT TË OKB-SË

3 DHJETOR 2024

Versioni i Shkurtuar

T'i jepet fund dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri

Parashtrim i pozicionit të OKB-së¹

Dhuna ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri përbën një shqetësim serioz, që shtohet edhe më shumë nga stigma dhe diskriminimi i vazhdueshëm shoqëror, pamjaftueshmëria e mbrojtjes ligjore dhe e shërbimeve mbështetëse për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Ky dokument përshkruan pengesat me të cilat përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, identifikon mangësitë në legjislacion që duhen adresuar në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar, si dhe propozon ndërhyrje konkrete për të siguruar që askush të mos mbetet pas.

Në të gjithë botën gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara kanë dy deri në katër herë më shumë gjasa që të përjetojnë dhunë nga partneri intim, krahasuar me gratë dhe vajzat që nuk kanë aftësi të kufizuara.² Ato janë veçanërisht të rrezikuara nga dhuna seksuale, ku 8 për qind e grave me aftësi të kufizuara, krahasuar me 5 për qind të grave që nuk kanë aftësi të kufizuara, kanë pësuar dhunë seksuale gjatë 12 muajve të fundit (para studimit). 13 për qind e grave me aftësi të kufizuara, krahasuar me 10 për qind të grave që nuk kanë aftësi të kufizuara, përjetojnë dhunë seksuale të paktën një herë gjatë jetës së tyre.³ Një studim në Evropën Juglindore dhe Lindore tregon se gratë me aftësi të kufizuara përjetojnë një shkallë më të lartë të dhunës fizike, seksuale dhe psikologjike, si dhe ngacmim seksual, të ushtruar si nga partnerët e tyre intimë ashtu edhe nga jo-partnerët.⁴

Gratë me aftësi të kufizuara përballen me forma të shumfishta të dhunës. Përveç dhunës fizike (si lëndim trupor dhe mosdhënie e kujdesit mjekësor), dhunës seksuale (përfshirë përdhunimin dhe shfrytëzimin e cenueshmërive të tyre) dhe ngacmimit seksual, dhuna psikologjike dhe emocionale janë gjithashtu të zakonshme, duke përfshirë kërcënimet, izolimin dhe gjuhën abuzuese. Për më tepër, dhuna ekonomike kufizon aksesin e tyre në burime financiare, ndërsa shkeljet e të drejtave seksuale dhe riprodhuese shpesh rezultojnë në shtrëngim për kryerjen e procedurave mjekësore. Dhuna obstetrike, sidomos gjatë lindjes, si dhe dhuna institucionale në institucione të përkujdesit, janë gjithashtu të përhapura, ku shumë gra përjetojnë neglizhencë, abuzim dhe institucionalizim të detyruar.

Dhuna ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri

Në Shqipëri, stigma dhe stereotipet për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara⁵ i kanë rrënjët thellë në normat kulturore dhe tradicionale. Aftësia e kufizuar shpesh konsiderohet si turp, gjë që çon në izolim shoqëror dhe presion ndaj familjeve që t'i fshehin ose izolojnë gratë me aftësi të kufizuara për të mbrojtur statusin social të tyre. Rolet gjinore i marginalizojnë më tej këto gra, sepse ato perceptohen si të paaftha për të përmbushur rolet tradicionale, si shërbimet e përkujdesit. Këto stereotipe kufizojnë mundësitë e tyre për ndërveprim social, arsimim dhe punësim, si dhe ndikojnë njëkohësisht në cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe sociale që ato marrin, duke përjetësuar kështu ciklet e varfërisë dhe varësisë.

¹ Dokumenti u hartua nga Grupi i Tematik dhe Rezultateve Gjinore të OKB-së (GTRG) me kontribute thelbësore nga Agustela Nini-Pavli, Konsulente gjinore dhe të Drejtave të Njeriut, UN Women Albania, dhe Monika Kocaqi, Konsulente e Lartë Kombëtare për Integrimin Gjinor dhe Dhunën ndaj Grave.

² Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh). 2023. "Disabilities" (Aftësitë e Kufizuara). Shih: <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/disability-and-health>.

³ Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB) 2024. "The Disability and Development Report 2024, "Accelerating the realization of the Sustainable Development Goals by, for and with persons with disabilities" (Raporti mbi Aftësinë e Kufizuar dhe Zhvillimin 2024, "Përshpejtimi i realizimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nga, për dhe me personat me aftësi të kufizuara"). <https://social.desa.un.org/publications/un-flagship-report-on-disability-and-development-2024>

⁴ UNFPA. 2020. "Violence against women living with disabilities in South-East and Eastern Europe - UNFPA Evidence Brief based on OSCE-led Survey on the Well-being and Safety of Women in South-East Europe and Eastern Europe" (Dhuna ndaj grave që kanë aftësi të kufizuara në Evropën Juglindore dhe Lindore – Dosje faktike e UNFPA-së bazuar në vërtetimin e drejtuar nga OSBE-ja mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave në Evropën Juglindore dhe Lindore). Shih: <https://eeca.unfpa.org/en/publications/violence-against-women-living-disabilities-south-east-and-eastern-europe>.

⁵ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD). 2015. "Profile of Social Exclusion of Persons with Disabilities" (Profili i përjashtimit social të personave me aftësi të kufizuara). Shih: <https://www.undp.org/sites/g/files/zskqke326/files/migration/al/Profili-PAK-shqip-web.pdf>; UNDP dhe Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSDHPAK). 2015. "Dhunë e padukshme – një vështrim mbi fenomenin e dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në Shqipëri. Shih: https://adrf.al/images/publications/Invisible_violence_adrf_report_eng.pdf; UN Women dhe FSDHPAK. 2018. "Raport vlerësimi: Dhuna ndaj grave dhe vajzave nga komunitete të pafavorizuara – një vështrim mbi fenomenin e dhunës ndaj grave dhe vajzave nga komuniteti rom, LGBT, dhe atyre me aftësi të kufizuara në bashkitë Elbasan, Vlorë, Tiranë dhe Shkodër". Shih: https://adrf.al/images/publications/Raporti-Dhuna_ndaj_Grave_Vajzave.pdf.

Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara intelektuale janë veçanërisht të rrezikuara. Ato shpesh përjetojnë dhunë psikologjike dhe fizike që lidhet me varësinë e tyre nga personi kujdestar, si dhe paragjykime shoqërore që ndikojnë më tej në shëndetin e tyre mendor. Ndër format më të përhapura të abuzimit përfshihen mosdhënia e barnave, izolimi në shtëpi dhe kërcënimet emocionale, si kërcënimi për braktisje ose institucionalizim. Gratë me aftësi të kufizuara intelektuale dhe probleme të shëndetit mendor të nivelit mesatar janë veçanërisht të rrezikuara nga dhuna seksuale, trafikimi i qenieve njerëzore, prostitucioni dhe lypja. Dhuna psikologjike, e ushqyer nga paragjykimet, çon në shkelje të të drejtave të tyre, ndërsa presionet financiare shpesh rezultojnë në mohimin e aksesit në prona dhe asistencë sociale, si dhe në rrezik më të madh për institucionalizimin ose braktisjen e tyre.

Abuzimi mund të ndodhë kudo, në mjedise private dhe publike, në institucione dhe jashtë institucioneve (familje, punë). Abuzueset/abuzuesit janë zakonisht anëtarë/anëtarë të familjes (si prindërit, vëllezërit e motrat dhe gjyshërit), partneret/partnerët intimë ose bashkëshortet/bashkëshortët, kujdestaret/kujdestarët ligjorë, kujdestaret/kujdestarët dhe ofrueset/ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor. Varësia fizike, ekonomike dhe shoqërore e grave me aftësi të kufizuara përkeqëson më tej cenueshmërinë e tyre, duke pakësuar mundësitë për të kërkuar ndihmë, për të pasur akses në shërbime, ose për t'u përpjekur të largohen nga situata abuzive.⁶

Lidhja midis aftësisë së kufizuar dhe dhunës krijon një qark të dëmshëm. Gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara shpesh perceptohen si më të cenueshme, duke i bërë ato shënjestër të dhunës. Kjo është veçanërisht e vërtetë sidomos kur ato janë të varura nga kujdestaret/kujdestarët, çka rrit pabarazitë e pushtetit. Po kështu, aktet e dhunës mund të rezultojnë në lëndime të përhershme, që çojnë në aftësi të kufizuara afatgjata, ndërsa traumat mund të shkaktojnë probleme të shëndetit mendor që dëmtojnë funksionimin e përditshëm të tyre. Kjo dhunë keqëson izolimin social dhe komplikon përpjekjet për të kërkuar ndihmë. Gjithashtu, barriera si vështirësitë në komunikim dhe aksesit i kufizuar në burime pengojnë denoncimin e dhunës, ndërsa stigma që shoqëron si aftësinë e kufizuar ashtu edhe dhunën, i marginalizon më tej gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, duke bërë që cikli i dhunës të vazhdojë.

Në Shqipëri, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përballen me pengesa të konsiderueshme në aksesimin e shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës. Shumë ofrues shërbimesh nuk janë të ndërgjegjësuar dhe të trajnuar, çka çon në reagime të pamjaftueshme dhe izolim të mëtejshëm. Mbështetja sociale në nivelin vendor është e fragmentuar dhe anëtarëve/anëtarëve të Mekanizmave të Koordinuar të Referimit u mungojnë aftësitë e nevojshme për t'i trajtuar këto raste. GREVIO⁷ thekson se shërbimet janë shpesh të paaksesueshme, me mbështetje të pamjaftueshme për gratë me probleme të shëndetit mendor dhe nuk kanë masa që të sigurojnë aksesueshmërinë në gjykata apo rajone policie.⁸

Një numër organizatash të shoqërisë civile (OSHC) në Shqipëri avokojnë për të drejtat e grave dhe personave aftësi të kufizuara, përmes ofrimit të mbështetjes ligjore, promovimit të politikave përfshirëse dhe ofrimit të informacionit të aksesueshëm për mbrojtjen nga dhuna. Ato kontribuojnë gjithashtu edhe në përgatitjen e raporteve alternative mbi Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.⁹ Megjithatë, pavarësisht nga mbështetja më e madhe për OSHC-të, GREVIO vë në dukje se barrierat burokratike kanë kufizuar

⁶ UN Women dhe FSHDPAK. 2018. "Raport vlerësimi: Dhuna ndaj grave dhe vajzave nga komunitete të pafavorizuara – një vështrim mbi fenomenin e dhunës ndaj grave dhe vajzave nga komuniteti rom, LGBT, dhe atyre me aftësi të kufizuara në bashkitë Elbasan, Vlorë, Tiranë dhe Shkodër". Shih: https://adrf.al/images/publications/Raporti-Dhuna_ndaj_Grave_Vajzave.pdf; INSTAT. 2019. "Vrojtim kombëtar me bazë populatën: Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri", Shih: <https://www.instat.gov.al/media/6121/publikimi-dhuna-ndaj-grave-dhe-vajzave.pdf>.

⁷ GREVIO është grupi i eksperteve/ekspertëve për veprim kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, organi i eksperteve/ekspertëve të pavarur përgjegjës për monitorimin e zbatimit prej palëve të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

⁸ GREVIO. 2024. "First thematic evaluation report: Building trust by delivering support, protection and justice – ALBANIA" (Raporti i parë vlerësues tematik: ndërtimi i besimit përmes ofrimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë – Shqipëria). Shih: [1680b1a0ca \(coe.int\)](https://www.gre.io/reports/1680b1a0ca-coe-int)

⁹ Si p.sh.: Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) në bashkëpunim me Shoqatën Kombëtare Shqiptare të Njerëzve që nuk Dëgjojnë (ANAD), Shoqata e Invalidëve të Punës e Shqipërisë (SHIPSH), Shoqata e Invalidëve Para- dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë (SHIPTSH), Mbrojtja e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara (MEDPAK), Shoqata "Ndihmoni jetën" (SHNJ), Down Syndrome Albania, Fondacioni "Së bashku", Shoqata "Vepra tani" (2019); Caritas Albania (2019); Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë (2019); Fondacioni "Së bashku" në bashkëpunim me DSA, ANAD, MEDPAK, HLA dhe Caritas Albania (2024). Shih:

https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/TBSearch.aspx?Lang=en&TreatyID=4. Një listë e zgjeruar e OSHC-ve përfshirë ato puna e të cilave përqendrohet tek gratë me aftësi të kufizuara, gjendet në Qendrën Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri, Shih: <https://resourcecentre.al/csos-directory/>

aksesin e këtyre organizatave në fonde shtetërore, duke çuar në financim të pamjaftueshëm kronik për OSHC-të që mbështesin gratë me aftësi të kufizuara, përfshirë ato që i kanë mbijetuar dhunës.

Politikat efektive për luftimin e dhunës ndaj grave bazohen në mbledhjen e të dhënave solide.¹⁰ Megjithatë, në Shqipëri, ka mungesë të dhënash sistematike mbi gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, që i kanë mbijetuar dhunës. Kjo mungesë prek informacionet për shërbimet, reagimet institucionale dhe masat mbrojtëse, sikurse është theksuar edhe në raportin e KDKPAK-ut të vitit 2019.¹¹

Kuadri ligjor ndërkombëtar lidhur me dhunën ndaj grave me aftësi të kufizuara

Një numër traktatesh ndërkombëtare trajtojnë dhunën ndaj grave me aftësi të kufizuara dhe theksojnë ndërthurjen e barazisë gjinore me të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Mekanizmat e të drejtave të njeriut kanë hartuar gjithashtu udhëzues dhe rekomandime të detajuara për shtetet, lidhur me zbatimin e dispozitave përkatëse.

Këto përfshijnë Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK) dhe Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe organet e tyre (Komiteti i KDKPAK-ut dhe Komiteti CEDAW).¹² Komiteti i KDKPAK-ut ka miratuar [Komentin e përgjithshëm nr. 3](#) për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, që ofron udhëzime konkrete për masat përkatëse mbrojtëse. Po kështu, Komiteti CEDAW-së ka miratuar [Komentin e përgjithshëm nr. 18](#) për gratë me aftësi të kufizuara dhe [Komentin e përgjithshëm nr. 35](#) që trajton dhunën ndaj grave, përfshirë ndaj grave me aftësi të kufizuara. Të dy Komitetet pranojnë edhe ankesa të individëve kundër shteteve për shkelje të dispozitave të Konventave dhe kanë nxjerrë një numër vendimesh për raste që lidhen me dhunën ndaj grave me aftësi të kufizuara.

Shqipëria nuk është palë në Protokollin Shtesë të KDKPAK-ut të OKB-së, që do t'u mundësonte individëve ose organizatave të personave me aftësi të kufizuara të paraqisnin ankim kundër qeverisë për shkelje të neneve të Konventës, megjithëse mekanizmat e të drejtave të njeriut i kanë rekomanduar vazhdimisht Shqipërisë që ta ratifikojë Protokollin. Nga ana tjetër, pavarësisht se Shqipëria është palë e Protokollit Shtesë të CEDAW, asnjë rast kundër Shqipërisë nuk është paraqitur ndonjëherë në të.

Konventa e Stambollit e Këshillit të Evropës¹³ kërkon nga shtetet të sigurojnë që të gjitha masat për parandalimin, mbrojtjen dhe shërbimet për viktimat e dhunës të trajtojnë edhe prioritetet e grave me aftësi të kufizuara. Në shtator 2024, GREVIO – botoi [raportin e tij vlerësues tematik për Shqipërinë](#), ku evidentoi disa mangësi lidhur me mbrojtjen dhe shërbimet për gratë me aftësi të kufizuara. Mbrojtja e këtyre grave parashikohet edhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) e cila ka shqyrtuar një numër çështjesh në këtë fushë.¹⁴ Deri më sot, në Gjykatë nuk janë paraqitur ankime kundër Shqipërisë që ka të bëjë me dhunën ndaj grave me aftësi të kufizuara dhe që kur Shqipëria u bë anëtare e Këshillit të Evropës në vitin 1995, ka pasur vetëm një që kishte lidhje me dhunën ndaj grave.¹⁵ Kjo, pavarësisht jurisprudencës mjaft të pasur, të zhvilluar me kontributin e organizatave dhe aktivisteve të të drejtave të grave në të gjithë Evropën. Gjithësesi, standardet e Gjykatës janë detyruese për të gjitha shtetet anëtare dhe duhet të shërbejnë si udhërrëfyes për autoritetet shqiptare dhe OSHC-të që punojnë në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.¹⁶

Në vitin 2024 u miratua Direktiva e BE-së për luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e cila njohu faktin që gratë me aftësi të kufizuara përjetojnë shumë më tepër dhunë dhe shpesh hasin vështirësi në aksesimin e mbrojtjes dhe të masave mbështetëse. Shtetet anëtare të BE-së duhet të sigurojnë që këto gra të përfitojnë

¹⁰ Këshilli i Evropës. 2011. Shih: <https://rm.coe.int/168008482e>

¹¹ Shih rekomandimet në: <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/g19/304/81/pdf/g1930481.pdf>

¹² Ky komitet është një organ i përbërë nga eksperte/ekspertë të pavarur, i ngarkuar me: a) interpretimin e dispozitave të traktatit përmes Komenteve të Përgjithshme për tema specifike; b) rishikimin periodik të përparimit të shteteve përmes Vërejtjeve Përmbyllëse; dhe c) marrjen e ankesave të paraqitura nga individë kundër shteteve për shkelje të dispozitave të traktatit dhe kërkimin nga shtetet që të marrin masa ligjore në rast të një vendimi për shkelje. Sipas procedurës së tretë, Komiteti mund të marrë vetëm ankesa nga individët kundër shteteve që kanë njohur kompetencën e Komitetit për marrjen e këtyre ankesave, përmes ratifikimit të Protokollit Opsional të KDKPAK-ut.

¹³ Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.

¹⁴ Në bazë të nenit 2 – e drejta për jetë; nenit 3 – ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues; ose nenit 8 – e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare.

¹⁵ GJEDNJ. 2020. [Tërshana v. Albania \(Application No 48756/14\)](#)

¹⁶ Shih për shembull, *G.M. and Others v. the Republic of Moldova* (G.M. dhe të tjerët kundër Republikës së Moldavisë) GJEDNJ (nr. 44394/2015).

njësoj si personat e tjerë, duke u fokusuar në cenueshmërinë e viktimave dhe vështirësitë që kanë ato për të kërkuar ndihmë.¹⁷

Në nëntor 2024, OKB publikoi Raportin e saj kryesor mbi Aftësinë e Kufizuar dhe Zhvillimin, i cili bën thirrje për shërbime publike të aksesueshme, sisteme të forta të mbledhjes së të dhënave dhe kuadër politikash gjithëpërfshirëse. Raporti nënvizon nevojën për të pasur ofrues shërbimesh të trajnuar posaçërisht dhe programe që adresojnë sfidat unike me të cilat mund të përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara.¹⁸

Legjislacioni dhe politikat kombëtare

Në Shqipëri ekziston një kuadër ligjor dhe i politikave që trajton dhunën ndaj personave dhe grave me aftësi të kufizuara. Mbrojtje specifike janë përfshirë në legjislacionin e përgjithshëm ku trajtohet dhuna me bazë gjinore dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Me gjithë përmirësimet e bëra, disa nga dispozitat ligjore nuk zbatohen ose kanë mangësi. Në të njëjtën kohë, ekziston nevoja për harmonizimin e legjislacionit dhe të politikave.¹⁹

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë dhe aftësisë së kufizuar dhe ofron mbrojtje për gratë me aftësi të kufizuara.²⁰ Ato kanë të drejtë t'i paraqesin ankesa Komisionerit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe/ose gjykatave. Megjithatë nuk ekziston një praktikë e konsoliduar për jurisprudencën kundër diskriminimit apo një interpretim i mjaftueshëm i mbrojtjes nga diskriminimi në rastet e grave me aftësi të kufizuara që janë viktime të dhunës (për shembull, një grua që nuk mund të ketë akses në shërbime të specializuara për shkak të aftësisë së kufizuar). Kjo vjen pjesërisht nga mungesa e ndërgjegjësimit mbi ndërthurjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara me diskriminimin gjinor në organet kundër diskriminimit dhe OSHC-të.

Ligji për Dhunën në Familje ofron mbrojtje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me parimin e akomodimit të arsyeshëm. Aktet nënligjore²¹ përmbajnë disa kërkesa të përgjithshme për shërbime të aksesueshme, por mungojnë rregulloret specifike mbi aksesueshmërinë. GREVIO ka vënë në dukje se nuk ka protokolle ose procedura standarde të veprimit për trajtimin e grave viktime të dhunës në familje me probleme të shëndetit mendor.²² Kjo është e vërtetë edhe për gratë me aftësi të kufizuara të tjera, si fizike, shqisore, ose intelektuale. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ 2021-2030) siguron që masat për zvogëlimin e të gjitha formave të dhunës të fokusohen edhe tek gratë me aftësi të kufizuara. Strategjia synon ngritjen e shërbimeve të aksesueshme, por këto angazhime duhet të ndiqen nga masa të prekshme dhe fonde të qëndrueshme.²³

Kodi Penal kriminalizon dhunën në familje dhe krime të tjera me bazë gjinore, ku përfshihen veprat penale të kryera kundër grave me aftësi të kufizuara. Nëse vepra penale kryhet kundër personave me aftësi të kufizuara (si vrasja dhe trafikimi i qenieve njerëzore), ajo konsiderohet e kryer në rrethana rënduese dhe për të jepen ndëshkime më të rënda. Një dispozitë e veçantë parashikon si vepër penale gjithashtu marrëdhëniet seksuale me persona me aftësi të kufizuara me anë të shfrytëzimit të aftësisë së kufizuar mendore ose fizike të viktimave. Megjithatë, kjo

¹⁷ Bashkimi Evropian. 2024. *Directive of the European Parliament and of the Council on combating violence against women and domestic violence* (Direktivë e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit mbi luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje). <https://data.consilium.europa.eu/doc/document/PE-33-2024-INIT/en/pdf>

¹⁸ United Nations (UN). 2024. *The Disability and Development Report 2024, "Accelerating the realization of the Sustainable Development Goals by, for and with persons with disabilities"*, which is an update of the 2018 edition of the same flagship report, produced in response to a request by the United Nations General Assembly in its resolution 75/154 of 23 December 2020" (Raporti mbi Aftësinë e Kufizuar dhe Zhvillimin 2024, "Përsheptimi i realizimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm nga, për dhe me personat me aftësi të kufizuara", i cili është një përditësim i botimit të vitit 2018 i të njëjtit raport kryesor, përgatitur në përgjigje të një kërkesë nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në rezolutën e saj 75/154 të datës 23 dhjetor 2020). <https://social.desa.un.org/publications/un-flagship-report-on-disability-and-development-2024>

¹⁹ Kjo analizë nuk synon të jetë shteruese dhe të trajtojë të gjitha aspektet e kuadrit legjislativ për dhunën me bazë gjinore dhe për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Ajo thjesht synon të sjellë në vëmendje nevojën për të filluar një analizë më të thelluar të legjislacionit dhe politikave, si në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara ashtu edhe në atë të dhunës me bazë gjinore, për të siguruar harmonizimin dhe zbatimin efektiv të tyre.

²⁰ Bazuar në pranimin se dhuna ndaj grave është një nga manifestimet më brutale të diskriminimit gjinor.

²¹ VKM nr. 327, datë 2/06/2021 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare" dhe Urdhri Nr. 744 i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, datë 15.11.2019, "Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat/të mbijetuarat/it e dhunës me bazë gjinore dhe të dhunës në familje, në qendrat rezidenciale emergjente (afatshkurtra) publike dhe jopublike (strehëzat emergjente)".

²² GREVIO. 2024. *"First thematic evaluation report: Building trust by delivering support, protection and justice – ALBANIA"* (Raporti i parë vlerësues tematik ndërtimi i besimit përmes ofrimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë – Shqipëria). Shih: [1680b1a0ca \(coe.int\)](https://www.grevio.org/en/1680b1a0ca)

²³ Po aty.

nuk zbatohet për forma të tjera të dhunës me bazë gjinore ndaj grave me aftësi të kufizuara. Përveç kësaj, sterilizimi i detyruar, nga i cili mund të preken sidomos gratë me aftësi të kufizuara, nuk përkufizohet si vepër penale. Kodi i ri Penal, që është në proces hartimi, është një mundësi për t'i zgjidhur këto mangësi dhe boshllëqe. Kodi i Procedurës Penale dhe Kodi i Procedurës Civile kanë një numër mangësish, sidomos në lidhje me nenin 13 të KDKPAK-ut për akomodimin procedural dhe shërbime të aksesueshme ligjore për personat me aftësi të kufizuara. Në përgjithësi mungojnë masat dhe protokollet për eliminimin e barrierave ndaj aksesit në drejtësi dhe ofrimit të akomodimit të përshtatshëm procedural në procedurat gjyqësore për personat me aftësi të kufizuara.²⁴

Ligji për Ndhimën Juridike u ofron mundësi grave me aftësi të kufizuara të përfitojnë ndihmë juridike mbi bazën e statusit të personit me aftësi të kufizuar, si viktimat të dhunës, ose kur përballen me diskriminim. Numri i përfituesve/përfituesve të ndihmës juridike parësore po rritet në sajë të disa qendrave të ndihmës juridike falas.²⁵ Janë vënë re disa përmirësime në ofrimin e ndihmës juridike dytësore.²⁶ Megjithatë, nuk është e qartë nëse janë plotësuar kërkesat e grave me cenueshmëri të shumëfishta, si gratë me aftësi të kufizuara viktimat të dhunës, për shkak të mungesës së të dhënave të ndara sipas seksit dhe faktorëve të tjerë.

Legjislacioni për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Që nga ratifikimi i KDKPAK-ut në vitin 2013, është miratuar një kuadër ligjor dhe i politikave mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për të siguruar zbatimin e traktatit. Megjithatë, në këtë kuadër ka mungesë vëmendjeje ndaj situatës së grave me aftësi të kufizuara të cilat shpesh përballen me diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjinisë. Po kështu mungojnë lidhjet me legjislacionin dhe politikën mbi barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore. Për shembull, ndonëse Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara përmban garanci të përgjithshme për sigurimin e aksesueshmërisë në të gjitha fushat kryesore të jetës, ndër të cilat shërbimet e përkujdesit shoqëror, ai nuk përmend në mënyrë specifike legjislacionin për dhunën me bazë gjinore ose shërbimet e specializuara për gratë me aftësi të kufizuara viktimat të dhunës. Në mënyrë të ngjashme, Ligji për Shëndetin Mendor, i cili garanton mbrojtjen e personave me probleme të shëndetit mendor nga dhuna prej nëpunësve/nëpunësve/autoriteteve publike,²⁷ nuk përmban dispozita për mbrojtje nga dhuna e ushtruar prej individëve (kujdestare/kujdestarë, anëtare/anëtarë të familjes, ofrueset/ofruesit privatë të shërbimeve, etj.). Mungesa e të dhënave mbi situatën e grave me aftësi të kufizuara në Shqipëri u vu në dukje edhe nga Komiteti i KDKPAK-ut në vitin 2019, sidomos në lidhje me zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020.²⁸ Por me gjithë rekomandimet konkrete të Komitetit, Plani vijues i Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2021-2025) nuk i trajton format e ndërthurura të diskriminimit dhe dhunën me bazë gjinore me të cilën përballen gratë me aftësi të kufizuara.

Rekomandime

Duke pasur parasysh diskriminimin dhe dhunën e vazhdueshme me të cilat përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara në Shqipëri, për shkak të përkatësisë së tyre të shumëfishtë, nevojitet vëmendje urgjente nga organet legjislativë, organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, gjyqësori, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, ofruesit publikë dhe privatë të shërbimeve, OSHC-të, si dhe komuniteti ndërkombëtar. Ndër ndërhyrjet specifike mund të përfshihen:

Përmirësime dhe zbatim efektiv i kuadrit ligjor dhe politikave: Ligjet dhe politikën që trajtojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe dhunën ndaj grave duhet të forcohen për të trajtuar posaçërisht sfidat me të cilat përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Është me rëndësi thelbësore të bëhet harmonizimi ndërmjet ligjeve, së bashku me monitorimin dhe llogaridhënien e nëpunësve/nëpunësve të administratës publike në rast të mospërbushjes së detyrimeve të tyre. Ndërthurja e gjinisë dhe aftësisë së kufizuar kërkon qasje të përshtatura në politikën që luftojnë dhunën, duke siguruar që strategjitë të adresojnë njëkohësisht barrierat e lidhura me gjininë

²⁴ Komiteti i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK). 2019. *Concluding Observations on Albania* (Vërejtje përmbyllëse për Shqipërinë), <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/g19/304/81/pdf/g1930481.pdf>

²⁵ Që nga dhjetori 2023, ka 20 qendra të ndihmës juridike falas të menaxhuara nga Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas, 12 nga të cilat mbështeten nga buxheti i shtetit dhe 8 nga PNUD-i dhe Agjencia Austriake për Zhvillim. Shih: Raporti Vjetor i Departamentit të Ndhimës Ligjore Falas të Shqipërisë 2023. <https://ndihmajuridike.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/12.-Analiza-Statistikore-Dhjetor-2023.pdf>

²⁶ Në vitin 2022, nga ndihma juridike dytësore falas përfituan 982 persona, nga 1030 kërkesa gjithsej, 65% e kërkesave ishin nga gra.

²⁷ Sipas Kodit Penal të Shqipërisë, tortura, trajnimi çnjerëzor dhe degradues janë vepra penale të kryera ose nxitura nga dikush që ushtron funksione publike.

²⁸ Komiteti i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK). 2019. *Concluding Observations on Albania* (Vërejtje përmbyllëse për Shqipërinë), <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/g19/304/81/pdf/g1930481.pdf>.

dhe ato të lidhura me aftësinë e kufizuar. Krahas këtyre, integrimi i rekomandimeve të GREVIO-s, KDPAK-ut, KEGJFDG-së, dhe i organeve të tjera ndërkombëtare do të sigurojë harmonizimin me standardet ndërkombëtare.

Trajnimi i profesionisteve/profesionistëve: Të zhvillohet trajnim i specializuar për ofrueset/ofruesit e shërbimeve dhe punonjëset/punonjësit e rendit për ndërgjegjësimin e tyre mbi aftësitë e kufizuara, kujdesin në raste të traumave dhe reagimet efektive ndaj dhunës me bazë gjinore. Këto trajnime duhet të promovojnë ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe respektuese. Krahas kësaj, të ofrohen trajnime të posaçme për OSHC-të për forcimin e punës së tyre avokuese për të mbijetuarat e dhunës dhe përmirësimin e shërbimeve të domosdoshme për to.

Rritja e ndërgjegjësimit: Të zhvillohen fushata në shkallë kombëtare të organizuara nga qeveria dhe OSHC-të, për të promovuar ndërgjegjësimin për të drejtat dhe nevojat e grave me aftësi të kufizuara, duke theksuar ndërthurjen e aftësisë së kufizuar dhe dhunës me bazë gjinore. Është thelbësore që të përdoren materiale të aksesueshme dhe me gjuhë përfshirëse e të përshtatshme për të siguruar pjesëmarrjen efektive të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në këto nisma.

Financimi: Të caktohen fonde të posaçme për organizatat që ofrojnë shërbime për gratë me aftësi të kufizuara, duke siguruar mbështetje të qëndrueshme për përpjekjet avokuese dhe ndërhyrjet e tyre. T'u jepet prioritet në financim organizatave të drejtuara nga gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, për të forcuar zërin dhe për të theksuar nevojat e tyre.

OSHC-të për të drejtat e grave dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara: Të shtohet fokusi mbi çështjet që lidhen me të drejtat e grave me aftësi të kufizuara dhe dhunën ndaj grave me aftësi të kufizuara, përfshirë ofrimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara të përshtatshme, organizimin e aktiviteteve të fokusuara te avokimi dhe monitorimi, si dhe këshillimi ligjor në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për gratë me aftësi të kufizuara.

Mbledhja e të dhënave: Të krijohet një sistem gjithëpërfshirës për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas llojit të aftësisë së kufizuar për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara të cilat përjetojnë dhunë. Këtu duhet të përfshihen të dhëna për shkaqet, faktorët e riskut, aksesin në shërbime, shërbimet mbështetëse, zbatimin e urdhrave të mbrojtjes dhe ndihmën juridike falas. T'i jepet prioritet një sistemi të thjeshtuar të të dhënave që shmang duplikimin e sistemeve ekzistuese, si sistemi të informimit në nivel vendor për regjistrimin e rasteve të dhunës në familje ("REVALB") dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke siguruar që ai të jetë i lehtë për t'u përdorur dhe të përditësohet vazhdimisht. Të bashkëpunohet me institucionet akademike ose OJF-të për të siguruar saktësi më të madhe të të dhënave. Të kryhen rregullisht anketime dhe studime në përputhje me standardet ndërkombëtare, ku të përfshihen gratë me aftësi të kufizuara si të intervistuarat dhe mbledhëse të të dhënave për pasqyrimin e pikëpamjeve të tyre.

Fuqizimi i grave me aftësi të kufizuara: Të promovohet një përfaqësim më i madh i grave me aftësi të kufizuara në organe të zgjedhura, të nxitet pjesëmarrja e tyre në proceset vendimmarrëse që lidhen me dhunën ndaj grave, si dhe të mbështeten organizatat e drejtuara prej grave me aftësi të kufizuara, me qëllim që të fuqizohen zëri dhe perspektivat e tyre. Të forcohet pavarësia e tyre përmes rritjes së kapaciteteve për të marrë vendime të bazuara në informacion dhe për të bërë punë avokuese për të drejtat e tyre. T'u jepet prioritet programeve për fuqizimin ekonomik të grave me aftësi të kufizuara, të cilat janë të planifikuara posaçërisht për to, duke përfshirë trajnime profesionale dhe nisma punësimi, për të zvogëluar varësinë dhe për të lehtësuar cënueshmëritë ndaj dhunës dhe abuzimit ekonomik.

Përfshirja e komunitetit: Të shtohen nismat për përfshirjen e komunitetit që promovojnë përfshirjen dhe mbështetjen e grave me aftësi të kufizuara. Të inkurajohet pjesëmarrja vendore në përpjekjet ndërgjegjësuuese dhe parandaluese, për krijimin e një mjedisi më përkrahës, për të sfiduar stigmën në shoqëri dhe për të krijuar rrjete mbështetjeje që mund të parandalojnë dhunën dhe abuzimin. Të zhvillohet dhe të forcohet edukimi i prindërve dhe familjeve, për shembull nëpërmjet nismave që fokusohen në prindërimin e mirë.

Promovimi i barazisë gjinore: Të integrohen nismat e barazisë gjinore në të gjitha politikat dhe programet përkatëse, sidomos për trajtimin e sfidave unike me të cilat përballen gratë me aftësi të kufizuara dhe për promovimin e një shoqërie të drejtë dhe të barabartë.

Disponueshmëria dhe aksesimi në shërbimet mbështetëse: Të krijohet dhe të funksionojë në vijimësi një rrjet i shërbimeve mbështetëse posaçërisht për trajtimin e dhunës, në lidhje me gratë me aftësi të kufizuara, duke siguruar që këto shërbime të jenë gjithëpërfshirëse, me personel dhe fonde të mjaftueshme për t'iu përgjigjur nevojave të ndryshme. Të zhvillohen dhe strukturohen shërbime të reagimit emergjent për të adresuar kërkesat unike të grave me aftësi të kufizuara, duke garantuar kështu sigurinë e tyre në kohë krize dhe duke lehtësuar aksesin në ndihmë të shpejtë.

Aksesueshmëria: Të sigurohet që të gjitha shërbimet publike dhe private që trajtojnë dhunën ndaj grave të jenë plotësisht të aksesueshme nga gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, si fizikisht ashtu edhe digjitalisht. Të zbatohen parimet e dizajnit universal për të krijuar mjedise përfshirëse dhe të sigurohet që hapësirat publike të jenë të pajisura dhe t'iu përgjigjen nevojave specifike të tyre, duke forcuar kështu sigurinë dhe mbështetjen për të mbijetuarat. Të zbatohet parimi i akomodimit të arsyeshëm kurdo që është e mundur, për të plotësuar nevojat e grave me aftësi të kufizuara të ndryshme, përfshirë akomodimin procedural në kuadër të aksesit në drejtësi të grave me aftësi të kufizuara. Të përdoret teknologjia për të përmirësuar aksesueshmërinë për gratë me aftësi të kufizuara, duke krijuar mekanizma raportimi të aksesueshëm për rastet e dhunës dhe duke zhvilluar mjete digjitale për arsimimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit.

Fondi Social i Punësimit: Të përdoret Fondi Social i Punësimit dhe projekte të tjera të ngjashme për të forcuar përfshirjen sociale dhe në punësim të personave me aftësi të kufizuara. Të vihet fokusi mbi zbatimin e modeleve ekzistuese të shërbimeve të punësimit dhe të zhvillimit të aftësive në nivel vendor, duke u kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të grave me aftësi të kufizuara.

Monitorimi dhe vlerësimi: Të krijohen mekanizmat e duhur për monitorimin e zbatimit të këtyre rekomandimeve, si dhe të përfshihen gratë me aftësi të kufizuara në procesin e vlerësimit të zbatimit dhe ndikimit të ligjeve dhe programeve që lidhen me dhunën dhe diskriminimin, për të siguruar llogaridhënien dhe vlerësimin në vijimësi të përparimit të bërë.